



Pranimi / Dostizuar Puneheno / Prodado Received / Delivered	28.04	2023	3	viti god Year
Organ / Shënia Organ / Jednica Org / Unit	SHKIMSHICKA	3945 / 2023	113	Sasia Kolicina Quantity



## Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.510/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti, dhe Ardita Haxhnikaj-Demi -anëtarë, si dhe Sabile Avdyli- Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.510/2023 të datës 15.03.2023 të parashtruar nga ankuesi kundër organit të punësimit Komunes së Ferizajt, në çështjen juridike "shketje e të drejtës në pagë", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 28.04.2023, njëzëri mori këtë:

### V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.510/2023 e datës 15.03.2023, e parashtruar ankuesi

### A r s y e t i m

Nëpunësi civil i punësuar në Sektorin e Gjendjes Civile të Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme në Komunën e Ferizajt, me datë 15.03.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, lidhur me kategorizimin e pozitës së tij të punës nga Kategoria Profesionale 3 në atë 2.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 27.03.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Komuna e Ferizajt. Ndërsa Këshilli më datë 05.04.2023 ka pranuar përgjigje në ankesë së bashku me shkresat e lëndës.

Kolegji i Këshillit nga analizimi i provave të lëndës si dhe shqyrtimi i pretendimeve ankimore, konstatoi se ankesa e ankuesit është e palejuar, sepse:


Nga shkresat e lëndës konstatohet fakti se ankuesi është i punësuar në Komunën e Ferizajt dhe së i njëjti sipas Akt Emërimit të datës 01.07.2011 ushtron pozitën e punës "Zyrtare i Gjendjes Civile" në Sektorin e Gjendjes Civile ne Drejtorinë e Administratës së Përgjithshme të Komunës së Ferizajt, me koeficient të pagës pesë (5), sipas sistemit të vjetër të pagave. Me tej nga shkresat e lëndës rezulton së ankuesi në listën e pagave për muajin janar ka qenë i sistemuar në klasën profesional 2, ndërsa në muajin shkurt me hyrjen të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, është klasifikuar në klasën profesional 3.

Ankuesi, me datë 15.03.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor se Komuna e Ferizajt, pas hyrjes në fuqi të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, ka kategorizuar ankuesin në Kategorinë Profesionale 3, përkundër se i njëjti i plotëson të gjitha kushtet ligjore për Kategorinë Profesionale 2, të parashikuar në Rregulloren (QRK) Nr.10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil respektivisht i është ndryshuar klasa nga profesional 2 në klasën profesional 3 në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi.

Lidhur me pretendimet ankimore të ankuesit, Kolegji i Këshillit analizoi dispozitat e Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, i zbatueshëm nga data 05.02.2023, përkatësisht nenin 2 paragrafi 1 në lidhje me fushëveprimin ku parashihet se: "1. Ky ligj zbatohet për të punësuarat/it në sektorin publik pagat e të cilave/ëve financohen nga dhe përmes buxhetit të shtetit, ..... 2. Rregullat dhe kushtet për përcaktimin e pagës të të punësuarave/ëve në sektorin publik janë ekskluzivisht rregullim i këtij ligji dhe mund të rregullohen edhe me akte të tjera nënligjore, vetëm kur parashihet shprehimisht nga ky ligj", dhe nenin 14 paragrafi 3 të këtij ligji ku përcaktohet se: 3. Klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet në bazë të rregullave të vlerësimit dhe klasifikimit të pozitave të punës, sipas dispozitave për klasifikimin e pozitave të shërbimit civil, në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik, dhe si rrjedhojë, referuar këtij përcaktimi ligjor Kolegji i Këshillit konstatoi se paga bazë e nëpunësit civil përcaktohet sipas klasës së pagës, përkatësisht koeficientit, të cilit i përket pozita e punës, e përcaktuar në shtojcën Nr.10 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, ndërsa klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik, në këtë rast në pajtim me Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarë Publikë dhe Rregulloren (QRK) Nr.10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil.

Kolegji i Këshillit nga analizimi i shkresave të lëndës ka gjetur se organi i punësimit, gjegjësisht Komuna e Ferizajt, ende nuk e ka përfunduar procesin e klasifikimit të vendeve të punës për nëpunësit civil në kuadër të këtij institucioni, dhe se procesimi i pozitës së ankuesit në sistemin e ri të pagave, të krijuar sipas Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, nuk është si pasojë e klasifikimit të pozitës së tij të punës në kuptim të ligjit material, gjegjësisht Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe Rregullores (QRK) Nr.10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, por si rezultat i ekuivalencës së sistemit të vjetër me sistemin e ri të koeficienteve të përcaktuar me Vendimin Nr.04/128 të datës 16.02.2023 të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Andaj, duke qenë se me nenin 29 të Rregullores (QRK) Nr.10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, si dhe më pikën 5 dhe 6 të Vendimit Nr.04/128 të datës 16.02.2023 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, institucionet e administratës publike janë obliguar që të përgatisin klasifikimin dhe grupimin e pozitave të punës në pajtim me këtë Rregullore dhe



katalogun e vendeve të punës, jo më vonë se nëntë (9) muaj nga hyrja në fuqi e kësaj Rregulloreje, gjegjësisht deri me datë 30.09.2023, Kolegji i Këshillit vlerëson së ankesa e ankuesit lidhur me kategorizimin e pozitës së tij në kategorinë profesionale 3 është e parakohshme dhe si e tillë në këtë fazë nuk i plotëson kushtet ligjore për trajtim meritior, rrjedhimisht e njëjta është e papranueshme në kuptim të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kolegji i Këshillit, theksuar si më sipër, vlerëson se vetëm pas përfundimit të procesit të klasifikimit të pozitive të punës nga organi përkatës i punësisimit, sipas procedurës dhe afatit të theksuar me lartë, ankuesit i lindë e drejta e kundërshtimit dhe ankimit lidhur me klasifikimin e pozitës së tij të punës.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Kështu që mbështetur në nenin 18 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** *Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr. 510/2023.

Sabile AVDYLI  
*Sabile Avdyli*  
Procesmbajtëse

Malsore GASHI-BAJRAKTARI  
Kryetare e Kolegjit



**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Ferizajit; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së;

